



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakt i raportit përfundimtar të revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

UKIM- Fakulteti Farmaceutik Shkup

Lënda e revizionit:

Revizion i pasqyrave financiare për vitin 2019 së bashku me revizionin e pajtueshmërisë
Llogaria e buxhetit nga aktivitetet e vetëfinancimit (788-12)


Qëllimi i revizionit:

A janë pasqyrat financiare të liruara nga gabime në të gjitha aspektet materiale, si dhe aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to, a janë në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjendjet kyçe të identifikuara:

- nuk është miratuar procedurë për përcaktimin dhe mbledhjen e të ardhurave të realizuara në baza të ndryshme brenda veprimtarisë së arsimit të lartë;
- pagesa e shërbimeve kontraktuese nuk është në përputhje me aktet për pagimin e pagave të miratuara nga fakulteti;
- nuk mbahet evidencë për furnizimin dhe konsumimin e reagensëve dhe materialeve të tjera për punë laboratorike, pajisje për zyrë, produkte higjienike dhe materiale të tjera.

Opiniononi i dhënë *:



Shprehëm opinion me rezervë mbi realitetin dhe objektivitetin e pasqyrave financiare për vitin 2019, ndërsa për pajtueshmërinë e aktiviteteve, transaksioneve financiare dhe informacionit me legjislacionin, udhëzimet dhe politikat e vendosura shprehëm opinion të pafavorshëm

Rekomandimet kyçe:

- të ndërmarrë aktivitete për regjistrimin e të gjitha pagesave nga studentët dhe lidhjen e tyre me regjistrat e kontabilitetit, dhe
- harmonizimi i akteve / vendimeve sipas të cilave kryhet shpërblimi për kryerjen e punëve dhe detyrave shtesë që nuk janë pjesë e marrëdhënies së rregullt të punës me Vendimin për përcaktimin e pagës dhe llojin tjetër të shpërblimit.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Nuk është krijuar Këshilli Kombëtar për Arsimin e Lartë dhe Veprimtari Kërkimore Shkencore dhe nuk është propozuar Rregullore për vlerësim dhe kriteriume për financimin e arsimit të lartë deri tek Qeveria e RMV

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejte nga personi përgjegjës i subjektit lëndë e revizionit brenda afatit të dhënë për Draft raportin e revizorit shtetëror të autorizuar

Përgjigja ndaj vërejtjeve të marra:

./.

* pozitive, me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur